

DPK/DMP
02

03-1417/13
15-05-2013

Nr.regj. 62580/12

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEPERTAMENITI I PERGJITHSHËM/ Divizioni Kundërvajtës, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Suzana Manxhuku-Kërliu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së zyrtarëve të Lart Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1. 1 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 25.04.2013 merrë këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Suzana Manxhuku-Kërliu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së zyrtarëve të Lart Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar.

Pezullimi behet konformë neni 198 al.1 të LMK-es se fjalë për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjensia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr.01-4277/12 të dt 26.11.2012 për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit e për kundërvajtjen e lartëcekur.

Ne baze të kërkesës u degjua deklarata e të lartëcekurës e cila deklaroi se e kam marrë postin e ushtrueses së detyres së drejtoreshës së Instituteve Paraklinike që në gusht të vitit 2012 ku këtë detyrë e kam ushtruar në cilësi të drejtoreshës deri në muajin tetor, po të nëjtin vit është marrë vendim që të anulohet konkursi për drejtor në të gjitha klinikat dhe prej marrjes së atij vendimi unë dhe kolegët e mij jemi ushtrues detyrë të këtij posti. Në momentin kur e kam pranuar postin e drejtoreshës për herë të parë nuk kemi pasur asnjë informacion me të cilin do të njoftoheshim në mënyrë që të bënim deklarin e pasurisë, për një gjë të tillë jam njoftuar për herë të parë me datën 15.11.2012 me një njoftim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë të cilin ua prezentoj edhe si provë. Unë menjëherë pasi që e kam marrë këtë njoftim i jam drejtuar Agjencionit AntiKorrupsion dhe me datë 21.11.2012 e kam bërë deklarin e pasurisë. Dua të theksoj se në asnjë mënyrë nuk i jam shmangur obligimeve të tilla dhe se një gjë të tillë nuk e kam bërë as nga neglizhenca mirëpo këtë e kam bërë nga mosinformimi lidhur me këtë qështje. Këtë e dëshmon më së miri fakti se një lëshim të tillë nuk e kam bërë vetëm unë po këtë e kanë bërë gjithë kolegët e mij të cilët për herë të parë jemi emëruar në pozitën e drejtorit nëpër klinika.

Sipas kërkesës se ushtruar, marrjes në pyetje të pandehurës dhe prova të tjera të administruara në lëndë, siq është njoftimi i datës 15.11.2012 i Ministrisë së Shëndetësisë, lista e nënshkrimit të drejtorëve lidhur me njoftimin e po kësaj date, formulari i deklarimit të pasurisë me datë 22.11.2012 u vërtetua në masë të mjaftueshme se në veprimet e të pandehurës nuk ka elemente të veprës së kundërvajtjes, andaj konform neni 198 al.1 të LMK-së e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse ndaj të lartëpërmendurit, se fjalë për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje.

Më sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet **Ankese** Gjykates se Apelit-Divizionit per Kundervajtje , brenda 8 ditësh pas marrjes se të njëjtit përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEPERTAMENITI I PERGJITHSHËM/ Divizioni i Kundërvajtës

Gjyqtarja
Saranda Bogaj-Sheremeti

